

*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

13.11.2023

Ora 11:00

RENDI I DITËS

***Projektvendim “Shqyrtimi i elementit e të formës dhe përmbajtjes për kërkesën e
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.35 të datës 02.11.2023***

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,
z. Ledio Braho. Mungon Z,K.Bebe.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaç, znj. I. Osmanaj,
- **Të tjerë:** Përfaqësues i Organizatës Drejtësia Sociale Znj.
Gj.Bakalli
- **Përfaqësues nga Ministria e Kulturës Znj.Xh.Xhaferi, znj.F.Islami**

Z.L.Braho: Çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës së Komisionerit nr.35 të datës 02.11.2023. Në seancën paraprake është vendosur kalimi i kësaj çështje për shqyrtim. Sot është trupa e KAS-it e përbërë nga 4 anëtarë pra formohet kuorumi. Po ashtu të pranishëm është administrata e KQZ-së, të pranishme janë përfaqësueset e Ministrisë së Kulturës, Organizata Drejtësia Sociale. Njoftimet janë bërë për Bashkinë Tiranë dhe për Teatrin e Operas dhe Baletit, të cilët kanë dijeni për këtë seancë, por nuk janë të paraqitur. Nuk e di të na informojë administrata e KQZ-së në lidhje me njoftimet e tyre, në lidhje me faktin nëse ka ndonjë kërkesë për mosprezencën e tyre.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcamaç*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Z.Y.Merkaj: Jo, janë njoftuar të gjithë personat përgjegjës për të marrë pjesë në këtë seancë të shqyrtimit administrativ por nuk kemi ndonjë përgjigje për mospjesmarrjen e tyre.

Z.L.Braho:Faleminderit zoti Merkaj, ju lutem përfaqësuesve të palëve të tjera që janë në seancë të bëjnë një prezantim të vetes.

Znj.F.Islami: Përshëndetje nga Ministria e Kulturës, juriste pranë kësaj ministrie.

Znj.Xh.Xhaferi:Personi përgjegjës për raportimin e aktiviteteve.

Z.L.Braho:Faleminderit për Organizatën Drejtësia Sociale, prezantohuni.

Znj.Gj.Bakalli: Juriste e Organizatës Drejtësia Sociale.

Z.L.Braho: Besoj se keni autorizim nga kjo organizatë.

Znj.Gj.Bakalli: Po me autorizim.

Z.L.Braho: Keni ndonjë kërkesë paraprake në lidhje me trupën e KAS-it? Sipas kërkesës nr.35 që cituam në hyrje Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi ka kryer një hetim administrativ të konsiderueshëm në kohë ka vendosur që të kërkojë dënimin administrativ me gjobë për Zonjën Zerina Bruci si person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Kulturës, gjobë që është kërkuar në masën 3 mijë lekë. Arsyeja për të cilën është kërkuar vendosja e këtij dënimi

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

administrativ ka të bëjë me faktin se sipas Komisionerit Ministria e Kulturës ka kryer një aktivitet publik të cilin nuk e ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve KQZ aktivitet ky që sipas Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka cënuar periudhën përpara zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023. Si fillim fjala është për përfaqësuesit e ankimuesit pra përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës dhe më tej për denoncuesit. Kështu që shkurtimisht argumentet kryesore dhe prova që nuk i keni prova në lidhje me pretendimet tuaja në ankim.

Znj.F.Islami:Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve shkurtimisht në themel Ministria e Kulturës ashtu sikurse u shpreh dhe në seancën paraprake të zhvilluar herën e fundit mban qëndrimin që institucioni organizues i këtij aktiviteti është Bashkia Tiranë dhe jo Ministria e Kulturës. Referuar komunikimit që është përcjellë nga kabineti i titullarit të institucionit tonë, titullari i institucionit në këtë aktivitet ka qenë e ftuar në cilësinë e të ftuarit. Bashkëlidhur ne kemi korrespondencën me email si edhe ftesën që i është përcjellë zonjës Elva Margariti. Në qoftë se mundet që të administrohet si provë?

Z.L.Braho: Fillimisht këto prova nuk janë administruar gjatë hetimit administrativ?

Znj.F.Islami:Jo i nderuar në seancën e kaluar thjesht...

Z.L.Braho:Jo në seancën e KAS-it, po flas për hetimin administrativ disa mujor që ka zhvilluar Komisioneri nuk janë paraqitur këto prova?

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Znj.F.Islami:Kemi pasur një mosrakordim përsa i përket marrjes në dijeni të komunikimeve nga ana e KQZ-së, sepse komunikimet fillimisht janë përcjellë në emër të zonjës Valbona Bataj dhe zonjës Entela Çipa që nuk janë personat e kontaktit për raportimet e veprimtarive publike. Valbona Bataj është një ish- punonjëse e Ministrisë së Kulturës dhe zonja Entela Çipa ka pozicionin Drejtore e Përgjithshme pranë Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore dhe të Artit. Komunikimi i drejtuar pikës së kontaktit, ka filluar më vonë në periudhën gusht mos gaboj dhe kjo është bërë forword nga sekretaria e TOB-it institucionit tonë të varësisë. Komunikimi zyrtar ka qenë në 02 Nëntor 2023 ku pikës së kontaktit komunikohet miratimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z.L.Braho: Pra ju jeni vënë në dijeni pas vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve?

Znj.F.Islami:Zyrtarisht po dhe nuk kemi pasur mundësi të paraqesim informacion më të detajuar dhe shterues nga ana jonë.

Z.L.Braho:Paraqitini provat tek administrata e KQZ-së dhe ne në vendim të ndërmjetëm do të vendosim në qoftëse do i pranojmë për shqyrtim.

Znj.F.Islami:Shkurtimisht ky është qëndrimi ynë.

Z.L.Braho:Pra ju i qëndroni faktit se nuk keni qenë organizatorë aktiviteti dhe nuk jeni ju institucioni që do ta kishit raportuar si aktivitet.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Znj.F.Islami:Jo është Bashkia Tiranë.

Z.L.Braho: Faleminderit fjala për përfaqësuesin e denoncuesit.

Znj.Gj.Bakalli: Atëherë ne i qëndrojmë denoncimit që kemi bërë edhe ne ndajmë qëndrimin që mban dhe Ministria e Kulturës që është një aktivitet që është një aktivitet që është kryer nga Bashkia Tiranë dhe është një aktivitet politik dhe jo kulturor. Ne kërkojmë që të administrohet duke qenë se është cituar dhe në mbledhjen e kaluar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të administrohet si provë ftesa dhe komunikimet që ka pasur mes Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Tiranë për aktivitetin e datës 04 Maj. Gjithashtu siç e kemi cituar kërkojmë, duke qenë se seancat e bëra pranë Komisionerit Ministria e Kulturës nuk ka qenë prezent dhe kanë qenë prezent përfaqësues të Teatrit të Operas dhe Baletit ne kërkojmë që kjo provë të administrohet dhe të merren masa ndaj Bashkisë Tiranë dhe për zonjën Bruci që ka bërë ankesën të merret një masë më e lartë sanksioni jo vlera minimale që është caktuar, por një vlerë më e lartë duke pasur parasysh dhe vendime të tjera që ka marrë KAS-i për procese tjera dhe për ankimet e tjera.

Z.L.Braho:Faleminderit të qartësojmë diçka ju ishit e idesë që organizatorja e aktivitetit ishte Bashkia Tiranë dhe jo Ministria e Kulturës. Pse duhet të vendoset sanksion administrativ për zonjën Bruci që është Sekretare e Përgjithhsme e Ministrisë së Kulturës dhe personi përgjegjës, pra kërkonte që të dënohen administrativisht edhe përfaqësuesja e Ministrisë dhe përfaqësuesi i bashkisë?

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Znj.Gj.Bakalli: Po sepse kanë qenë të dy prezentë dhe pavarësisht se është ftesë e organizuar nga bashkia, prania e ministres përbën një veprimtari të ndaluar sipas Kodit Zgjedhor kështu që duhet të marrin të dyja palët sanksione.

Z.L.Braho:Faleminderit.

Znj.F.Islami:Duam të qartësojmë përfundimisht datën e zhvillimit të aktivitetit që ka qednë data 3 Maj dhe jo data 4 Maj. Data 3 Maj kemi edhe foto të postuara në rrjetin social Instagram të zonjës Elva Margariti që është zhvilluar ky aktivitet në datën 03 Maj. Për sa i përket përegjesisë ne vazhdojmë të mbajmë qëndrimin që në zbatim dhe të vendimit të Komisionit Rregullator 2021 për sa i përket raportimit të veprimtarive publike është pikërisht organizuesi i aktivitetit ajo që mban edhe përgjegjësinë për raportimin e veprimtarisë publike, ftuesit, median në sallën ku është realizuar dhe të gjithë procedurën e ndjekur.

Z.L.Braho:Fjala për Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së në lidhje me qëndrimin që ai ka për kërkesën e Komisionerit.

Z.Y.Merkaj: Shqyrtimi administrativ është marrë denoncimi në datën 04.05.2023 në orën 16:30 Ministria e Kulturës dhe Kryetari i Bashkisë kanë zhvilluar një takim në mjediset e hollit të Teatrit të Operas dhe Baletit me anë të institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe drejtues të Teatrit Kombëtar Ekperimental dhe në varësi të Bashkisë së Tiranës dhe drejtues të Teatrit e Metropolit, Shtëpia studio Kadare nga Liria e Arteve Tiranë. Ky takim është bërë në kuadër të fushatës së zgjedhjeve lokale pretendon ankimuesi në një ambient kulturor ku është në varësi të Ministrisë

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcama*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

së Kulturës. Mbështetur në përcaktimin e nenit 8 pika 3 të vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator është shqyrtuar paraprakisht çështja dhe është vlerësuar si infomacion e treguar kjo në bazë e mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ. Në këto kushte në datën 11.05.2023 administrata e KQZ-së ka kërkuar informacion nga personat përgjegjës për raportimin e veprimtarive pranë Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Tiranë dhe Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, i është kërkuar një informacion në lidhje me indiciet e marra ku rezulton se asnjë prej institucioneve brenda afatit ligjor nuk ka kthyer përgjigje. Gjithashtu në datën 11.05.2023 ora 12:00 janë ftuar palët në proces pjesë por asnjë prej palëve nuk është paraqitur në seancë. Është shtyrë dhe zhvillimi i seancës për në datën 27 Korrik 2023, ndërmjet postës elektronike i është kërkuar palëve pretendimet përfundimtare pasi do të vijojnë me vendimmarrjen dhe përsëri asnjë prej personave përgjegjës nuk ka raportuar dhe nuk kemi informacion në lidhje me këtë çështje. Në orën 18:00 deri në orën 12:00 të gjitha palët e proceseve janë ftuar në seancë publike për të dhënë shpjegimet e tyre përfundimtare. Në lidhje me këtë çështje dhe duke qenë se çështja kërkonte hetim të thelluar për të zbuluar organizatorët e kësaj veprimtarie publike është shtyrë për një datë tjetër. Në seancën publike u paraqit në cilësinë e përfaqësuesit të insitucionit Teatrit Kombëtar dy përfaqësuese zonja Migena Biba dhe zonja Greta Gjinaj, të cilat kanë pretenduar se në datën 04.05.2023 në katin e dytë të Teatrit Kombëtar janë zhvilluar dy veprimtari është koncerti i parë Frederik Ebert dhe për të cilën është disponuar dhe një kontratë dhe po të njëjtën ditë shtë zhvilluar koncerti i dytë Troket Folk nga maestro Armando Kllogjeri. Në kuadrin e hetimit administrativ për shqyrtimin e rastit i është kërkuar përfaqësuesit të institucionit të sjellin kontratën e qerasë dhe të sjellin pamjet filmike video në lidhje me koncertin e dytë të cilët i kanë sjellë i kanë dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcama*




*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

10.06.2023. Gjithashtu në seancën publike janë shpjegimet nga të dy përfaqësuesit e Teatrit të Operas dhe Baletit ku pretendohet se nuk është organizator Teatri i Baletit për organizimin e kësaj veprimtarie por është Ministria e Kulturës dhe si institucion varësi i Ministrisë së Kulturës nuk mund të ndalojë një veprimtari që organizohet nga Ministria e Kulturës. Në seancë publike është provuar se është zhvilluar në hollin e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe për nga natyra fjalimet e pjesmarrësve dhe provohet se është veprimtari publike e organizuar nga Ministria e Kulturës. Provohet se pjesmarrja e zotit Veliaj në kuadër të detyrimit të tij funksionale dhe nuk provohet të ketë thirrje elektorale apo mbështetje për të favorizuar si një kandidat i regjistruar në zgjedhjet për Kryetar i Bashkisë së Tiranës. Zhvillimet e veprimtarisë publike në ambientet e hollit dhe institucione publike për të zhvilluar për përmbushjet e detyrave funksionale të institucionit që ka organizuar këtë veprimtari publike dhe nuk ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Teatrit të Operas dhe Baletit. Por kjo veprimtari ka qenë publike dhe ka qenë personi përgjegjës i institucionit që organizon këtë veprimtari dhe rasti konkret është Ministria e Kulturës i cili duhet të kishte raportuar për zhvillimin e kësaj veprimtarie publike. Referuar sa më sipër Komisioneri duke vlerësuar që personi përgjegjës është sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës referuar nenit 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor ka propozuar KAS-it për marrje e masës administrative gjobë në vlerën 3 mijë lekë. Faleminderit.

Z.L.Braho: Po shqyrtoj provat zoti Merkaj dhe nuk pashë kontratë qeraje. Nuk e di a i kanë sjellë apo jo? Kam disa fotografi, disa emaile.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Z.Y.Merkaj: I kemi, i ka dërguar me email dhe kontratën e qerasë dhe pamjet filmike, video.


Z.L.Braho: Më duhet dosja e plotë që ka shqyrtuar Komisioneri. Po fjalën e ka zoti Rusmali për pyetje.

Z.I.Rusmali: Fillimisht me përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, ju thoni se ministria nuk ka qenë organizatore e aktivitetit dhe provoni me dokumentin që sollët sot për të administruar. Unë ndoqa pamjet video të veprimtarisë siç janë publikuar në rrjetin social nga ministrja fjalën e vetë duke thënë e fillon duke thënë unë bashkë me Erjonin ju ftuam, mos ka ndonjë kundër thënie me atë që tregoni tani?

Znj.F.Islami: Theksojmë se sot kemi ardhur në cilësinë e përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës. Përsa i përket fjalimeve të Ministres së Kulturës do të duhej ndoshta një përfaqësues i ndryshëm nga ne, por për sa i përket fjalimeve të mbajtura nuk kemi informacion. Ne përcollëm sot komunikimin zyrtar të kabinetit të ministrit i cili sqaron se ky aktivitet është organizuar nga Bashkia Tiranë, ka përcjellë pranë ministres ftesën si ne e depozituam si provë dhe mbajmë qëndrimin që personi përgjegjës në këtë rast është Bashkia Tiranë.

Z.I.Rusmali: Për këtë deklaratë në fillim të takimit nuk e alokoni dot në raport me provën, prova juaj është ajo që është dokumentuar jo ajo që thotë ministrja se nuk ka rëndësi se ju nuk jeni avokat, jeni përfaqësues të ministrisë këtu nuk vini nga jashtë nuk keni profesionin e avokatit. Pyetja tjetër ju deklaruat që aktiviteti është zhvilluar në datën 3 Maj, e për këtë referuat te postimi tjetër i ministres në Face

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

book, kjo është prova e vetme që keni për faktin se është zhvilluar në datën 3 Maj?
Apo keni ndonjë dijeni tjetër nga rrethana tjera që mund ta ndani me ne?

Znj.Xh.Xhaferi: Jo vetë ftesa thuhet me datën 3 Maj.

Z.I.Rusmali: Domethënë vetëm pjesa dokumentare që ju dispononi asgjë tjetër.

Znj.Xh.Xhaferi: Është vetëm komunikimi zyrtar nga kabineti i ministrit ftesa si dhe fotoja që ka postuar nga rrjeti instagram.

Z.I.Rusmali: Për denoncuesin kisha një pyetje, ju e keni bërë denoncimin tuaj fillimisht duke denoncuar për shkelje të detyrimit për raportim dhe bashkë me të, po pa e shtjelluar keni denoncuar ngjarja përbën shkelje të dispozitave për veprimtaritë e ndaluara për t'u promovuar por nuk e keni shpjeguar në vazhdim. A keni marrë pjesë në seancë të hetimit paraprak dhe në seancën përfundimtare të zhvilluar nga Komisioneri jo ju personalisht po përfaqësuesi tjetër ka kërkuar dënimin e kryetarit të bashkisë për shkelje të dispozitave lidhur me moslejimit të përdorimit të aseteve publike në fushatë të Ministres së Kulturës për pjesmarrjen në një veprimtari ku janë përdorur asete publike të ndaluara dhe të drejtoreshës për vënie në dispozicion të aseteve. Sot në fillim kërkuat që personi përgjegjës i ministrisë të dënohet jo me aq sa është dënuar por me më shumë për mos raportim. Duket se nuk jeni të sigurtë se çfarë kërkonti apo do e lemë pretendimet përfundimtare të na e ndani këtë.

Znj.Gj.Bakalli: Atëherë unë edhe përfaqësuesit jemi të qëndrimit që të tre personat duhet të mbajnë përgjegjësi duke qenë si edhe ju e cituat.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Z.I.Rusmali: Për çfarë shkelje?

Znj.Gj.Bakalli: Për përdorimin e aseteve publike gjatë fushatës nga përfaqësuesit e institucioneve publike.

Z.I.Rusmali: Po sekretarja e përgjithshme e institucionit që nuk ka përdorë asete çfarë përgjegjësie do të mbajë?

Znj.Gj.Bakalli: Edhe sekretari i përgjithshëm raporton ka përgjegjësi të caktuar.


Z.I.Rusmali: Tre personat plus dhe sekretarja e përgjithshme të katërt duhet të dënohen.

Znj.Gj.Bakalli: Po.

Z.I.Rusmali: Një pyetje për të dyja palët besoj edhe për administratën nëse ka dijeni shikojeni pak foton është video e aktivitetit. Kuarteti i harqeve të kujt janë këta e dini? I njihni keni ndonjë dijeni. Denoncuesi me dijeninë që ka apo dijenia që ju keni buron vetëm nga kjo video nga asgjë tjetër.

Znj.Gj.Bakalli: Ne kemi nisur denoncimin duke parë raportimin live që është bërë dhe që thamë data 3 ose 4 ne jemi nisur nga raportimi i videos live në Face book nga ministria.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcama*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Z.I.Rusmali: Po hulumtim të mëtejshëm nuk keni bërë.

Znj.Gj.Bakalli: Jo i vetëm hulumtim ky ka qenë duke qenë se është një provë e plotë me zë dhe figurë.

Z.I.Rusmali: Ju nuk jeni në gjendje të na thoni përshembull fonia që është përdorur në aktivitet e kujt është e Teatrit e vëndit ku është organizuar aktiviteti apo është e bashkisë, e partisë, e ministrisë apo është private e sekretares së përgjithhsme nuk keni ndonjë informacion për këto.

Znj.Gj.Bakalli: Nuk kemi informacion dhe nuk jemi nisur nga ajo anë, jemi nisur nga të pranishmit që kanë qenë përfaqësues që janë drejtues të institucioneve publike në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe bashkisë.

Z.I.Rusmali: Këtë gjë nuk na thoni dot për foninë jo, për kuartetin e harqeve jo na flisni vetëm për sallën e cila është jashtë çdo lloj dyshimi holli i Teatrit të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit Këngëve dhe Valleve Popullore. Ju nuk keni çfarë të thoni në këtë drejtim ju nuk keni informacion fare.

Znj.Gj.Bakalli: Jo nuk kemi informacion.

Z.Y.Merkaj: Kjo provë është sjellë nga Teatri Kombëtar për të treguar që janë zhvilluar dy veprimtari.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcama*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Z.I.Rusmali:Kjo nuk ka lidhje janë tepistime nga hetimi është evidente, ju keni hetuar një ngjarje që sipas të gjithë dokumentacionit që ju kishit në dispozicion ka ndodhur në datë 3 dhe keni thelluar hetimin fort se çfarë ka ndodhur në datën 4 në atë institucion. Ngjarja ka ndodhur në datën 3 Maj dhe keni pasur në dispozicion informacionin që ngjarja ka ndodhur në datën 3 Maj është deponim në gjykimin tim kolegët mund të kenë opinion tjetër. Prandaj nuk më intereson se çfarë ka ndodhur në datën 4 Maj dhe as provat që janë servirur për datën 4 Maj për këtë nuk ka. Nuk kam pyetje të tjera.

Z.L.Braho:Faleminderit.

Z.E.Çefa: Për përfaqësuesit e shoqatës që ka bërë dhe denoncimin doja të dija në qoftë se mund të na jepni më tepër sqarime lidhur me pretendimin që keni ngritur që aty është bërë propagant politike pra është folur për veprimtari konkrete të Bashkisë Tiranë me qëllim favorizimin e kandidatit për kryetar bashkie në zgjedhje të ardhshme.

Znj.Gj.Bakalli:Faleminderit për pyetjen, ne kemi bërë një zbardhje të gjithë diskutimeve që është mbajtur dhe fjalia hapëse e diskutimit i prezantimit është nga zonja Elva Margaritit që thotë: Shumë faleminderit që u bashkuat në ftesën time dhe të Erjonit se menduam se është moment i mirë, e dimë që fushata na sjell atë ritëm dhe vijon.. dhe gjithashtu gjatë diskutimit janë bërë dhe premtime, është bërë një lloj bilanci për çfarë ka ndodhur më përpara dhe është bërë dhe premtime elektorale për çfarë pritet të bëhet që pritet të ndërtohet teatri i ri i kukullave, një muze te Bulevardi i Ri dhe janë përmendur dhe artistë që do të merren me këtë pjesë. Përpiqem ta gjej

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

që ta citoj saktë dhe këto i ka thënë kryetari i bashkisë. Përshembull thotë që po mbaron Akademia e Arteve kemi futur një traditë të mirë në çdo shkollë nuk do të bëjmë dot një shkollë të madhe pa patur dhe një sallë koncertore, kur mendoj se sa teatro janë bërë është bërë dhe salla e Tonin Arapi te Liceu, apo salla Avni Mula te Shkolla Servete Maçi apo salla e Kinemasë Maks Velo janë gjëra qëi ka cituar vetë kryetari i bashkisë apo Kinema Agimi që janë institucione publike. Gjithashtu është dizenuar për një muze të artit modern ky është vendi i Zizder Xhafës dhe Anri Salës, është marrë dhe me personat që kanë qednë vetë prezent artistët që ka përmendur çfarë kanë bërë aktivitete bashkë. Nëse ju duhet mund ta vëjmë në dispozicion zbardhjen sepse ne e kemi bërë.

Z.E.Çefa:Faleminderit. Edhe diçka përfundimisht mund të më thoni ky aktivitet zyrtare si është prezantuar si është titulluar. Cili është qëllimi zyrtar pra pavarësisht sloganeve që mund të jenë thënë duke shfrytëzuar hapësirën por zyrtarisht arsyen dhe emërtimin, titullin?

Znj.Gj.Bakalli: Nuk ka qenë i qartë dhe ka pasur një tentativë për t'ia hedhur topin njëri-tjetrit kush kaqenë organizatori se e kemi parë dhe gjatë vlerësimit, diskutimit që pati me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Unë po përpiqem të gjej nga faqja e ministres se çfarë ka cituar për takimin, se cili ka qenë organizatori ka qenë kjo loja e hedhjes së topit.

Z.E.Çefa:Nuk e di nga përfaqësuesit e ministrisë mund të na sqaroni në këtë pikë ju lutem.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Znj.Xh.Xhaferi: Eventi quhet “Eja të flasim për artin” dhe çfarë u fol deri tani ishte gjithçka për sa i përket artit, gjithçka që është arritur duke filluar që nga sallat koncertore, Akademia e Arteve, deri më pas Teatri i Operas gjithçka mesa dëgjova unë nga vajza flasim gjithçka për artin. Kemi gjithashtu dhe emrin e eventit të shkruar te ftesa.

Z.E.Çefa: Unë nuk e kam parë edhe ftesën megjithatë nuk ka rëndësi. Një pyetje tjetër në funksion të kësaj, data 3 Maj ka ndonjë shenjë po themi në historinë e qytetit, pse pikërisht biseda për të folur për artin është lënë në këtë datë? Ka ndonjë përvjetor ndonjë ngjarje historike që njerëzit mblidhen përkujtojnë diskutojnë? Apo ka blerë dikush ndonjë vilionçel të ri?

Znj.Gj.Bakalli: Nëse mund ta citoj se e gjeta te postimi i ministres: Bashkë me Erjonin kaluam një moment ndryshe me miqtë tanë artistë këta që na frymëzojnë dhe na mbushin shpirtin me artin e tyre por që përtej skenës ndajmë të njëjta problematika. Në këto vite jemi përballë me sfida vështirësi po përpiqemi të luftojmë me kohën për të rikthyer insitucionet kulturore, dinjitetin që meritojnë që nga përfirmësimi i infrastrukturës te rritja e pagave, kemi edhe rrugë të gjatë përparaq do ta përshkrojmë së bashku falenderime për çdo njërin prej tyre për sakrificat në emër të artity. Ky është nga postimi që ka bërë ministrja në Instagram.

Z.L.Braho: Zoti sekretar i përgjithshëm po shoh këtë rendin ditës, proceserbalet mesa kuptoj unë janë bërë dy seanca pranë Komisionerit në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu siç tha dhe zoti Rusmali unë shoh se i gjithë debati i është nënshtruar këtij aktiviteti i datës 4 Maj, që është koncerti të paktën në seancën e parë. Ndërkohë po

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcama*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

shoh seancën e dytë dhe sërish ka pretendime filloj janë zhvilluar dy aktivitete pra megjithëse keni bërë një hetim të thelluar disa mujor unë shoh se këtu ka paqartësi për datën pra deri sa kemi ardhur te kjo seancë.

Nga hetimi juaj administrativ çfarë ka rezultuar? Ky aktiviteti që ne po shqyrtojmë sot është i datës 3 Maj apo 4 Maj?

Z.Y.Merkaj: Shqyrtimi administrativ ka nisur me denoncimin e denoncuesit i cili ka dhënë si provë provën link e cila është te faqja e Face book e ministres Elva Margariti e cila ka shfaqur live këtë video në datën 4 Maj. Duke nisur se ka qenë live gjithë perceptimi ka qenë se është bërë me datën 4 Maj, sepse live nënkuptohet..

Z.L.Braho: Live në konceptin e Face book-ut, po aq njohur modeste që kam unë nga teknologjia di që live mund të hidhen dhe ditë tjera sidomos kryetari i bashkisë e aplikon...

Z.Y.Merkaj: Po në fakt është bërë në datën 3 Maj, bëhet fjalë për të njëjntën veprimtari.

Z.L.Braho: Pra nuk ka bëjë me aktivitetin që ka një kontratë qeraje me Fridri Shebert?

Z.Y.Merkaj: Jo këto të dyja janë sjellë si prova nga Teatri Kombëtar për të treguar që nuk është zhvilluar në të njëjntën datë dhe nuk kemi qenë organizatorët e kësaj veprimtarie publike.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Znj.Gj.Bakalli: Ne kërkojmë që në bazë të provave të bëhet vlerësimi nga ana e përfaqësuesve të Komisionit Sanksionit dhe Ankimimeve për të lënë në fuqi vendosjen e masës jo masën ndaj përfaqësueses së ministrisë. Gjithashtu dhe për përfaqësuesit e bashkisë dhe për Operan që të ketë një masë nga ana juaj.

Z.L.Braho: Pra kërkon pranimin pjesërisht të kërkesës së Komisionerit?

Znj.Gj.Bakalli: Po.

Z.L.Braho: Zoti sekretar i përgjithshëm po ju?

Z.Y.Merkaj: Dhe ne kërkojmë pranimin e kërkesës së Komisionerit me një rregullim të vogël duke rregulluar datën nga data 4 Maj të mbajë datën 3 Maj.

Z.L.Braho: Dakord KAS do të tërhiqet për vendim.

Rifillon Mbledhja ora12:02

Z.L.Braho: Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës nr.35 të datës 02.11.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. KAS pasi u tërhoq për vendim bazuar në nenin 21, pika 1 shkronja “dh” e Kodit Zgjedhor, me shumicë votash vendos:

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcama*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.11.2023*

Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe pranimin e pjesëshëm të kërkesave të palës së interesuar Organizata Drejtësia Sociale.

Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Erjon Veliaj sipas nenit 172 pika 1 të Kodit Zgjedhor me gjobë masën 155 mijë lekë.

Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Elva Margariti dhe zonjës Abigela Goshtina sipas nenit 171 pika 2 të Kodit Zgjedhor me gjobë masën 2 mijë e 500 lekë.

Pushimin e hetimit administrativ për zonjën Zerina Bruci person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike Ministria e Kulturës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pikën 2 të dispozitivit. Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës administrative të apelit brenda 3 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Për pikën 3 të dispozitivit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi. U shpall sot në datën 13.11.2023. E deklarojmë seancën e mbyllur.

Vendim nr. 190

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcama*

